



| | |
|---------------------------|--|
| Datë/Datum/Date: | 16.07.2024 |
| Referenc-ë | |
| Për/Za/To: | z.Arber Zenuni, Kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit |
| CC: | Anëtarët e kuvendit komunal të Rahovecit |
| Përmes/Preko/Through: | |
| Nga/Od/From: | z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike |
| Subjekti/Predmet/Subject: | Informatë |

Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit sipas planint dhe kontratave qe ka, si dhe nje plani te hartuar nga ekspert të fushave të drejtorisë së shërbimeve publike si dhe me ndihmën e mbështetur nga ekspert të projektit DEMOS ka realizuar planin per pastrim te hapësirave publike.

Komuna e Rahovecit ben pastrimin e hapësirav publike ne te gjitha lagjet urbane dhe ne 35 vendbanime.

Zonat e përfshirjes se HHP-ve në këtë dokument përfshin;

1. Mirëmbajtjen e gjelbërimit, të ulët, të mesëm dhe të lartë,
2. Mirëmbajtjen e ambienteve të ndërtuara, sheshe, shtigje për këmbësorë dhe sipërfaqe të shtruara,
3. Mirëmbajtjen e hapësirave për parkim automjetesh,
4. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve
5. Mirëmbajtjen e varrezave, lapidareve, pllakave përkujtimore, etj..

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Rahovecit janë këto:

- Parqe gjelbërime,
- Sheshe,
- Shëtitore pranë lumit,
- HHP-të pranë lapidareve,
- HHP-të pranë pllakave përkujtimore,

KOMUNA RAHOVEC

- Varreza të dëshmoreve,
- Varreza të martireve,
- Varreza në zonën urbane,
- Varreza në zonën rurale,

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat, duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikuara risi është edhe larja dhe lysterja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës së Rahovecit.

Po ashtu në kontratat e mirëmbajtjes së hapësirave publike janë të specifikuar edhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave në pronë publike. Në komunën e Rahovecit kemi kontraktuar dy operator ekonomik që kujdesen për mirëmbajtjen e hapësirave publike. Ky projekt i ndarë në 2 Lote në afat prej 24 muaj nga data që janë lidhur kontratat:

- **Lot 1- 159,730.26 euro, janë të evidentuara 106 pozicione për pastrim apo larje,**
- **Lot 2- 63,226.38 euro, janë të evidentuara në kontrate 56 pozicione apo larje.**

Këto dy kontrata kanë afat 2 vjet në realizim të mirëmbajtjes së hapësirave publike.

Vlera e tyre në total për dy operator ekonomik sillet në **222,956.64 euro.**

Për më shumë detaje dhe sqarime tjera, do të jemi të hapur të diskutojmë gjatë mbledhjes së KPF-së dhe Mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtorja e Shërbimeve Publike

KOMUNA RAHOVEC